



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-017
Prishtinë, më 14 prill 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 PRILL 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala,
Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri (3) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 30 mars 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 30 mars 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 30 mars 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i Kuvendit, para diskutimit për miratimin e agjendës për seancë plenare, i njoftoi anëtarët e Kryesisë me pikat e mbetura nga mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 30 mars 2015, dhe nga seanca plenare, e mbajtur më 7 prill 2015, si në vijim:

1. Propozim-rezoluta e Grupit Parlamentar të PDK-së për të vënë drejtësi për gjenocidin dhe krimet e luftës të kryera nga Serbia ndaj popullsisë së Kosovës, dëmet e luftës të shkaktuara ndaj popullit dhe pasurisë së Kosovës, si dhe për ta zbardhur fatin e personave të zhdukur gjatë luftës,
2. Kërkesa e deputetit Nait Hasani, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë tjerë, për debat parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginë të Preshevës,
3. Rekomandimi i Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e lartshënuara, vendosi që pikat një (1) dhe dy (2), të shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Kryesisë, ndërsa për pikën 3 konstatoi që nëse Komisioni FunkSIONAL i procedon rekomandimet e harmonizuara, të njëjtat mund të radhiten për shqyrtim në seancën plenare, që do të mbahet më 16 prill 2015.

* * *

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 16 prill 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA,*
- 5. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale,*
- 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,*
- 7. Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim,*
- 8. Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore,*
- 9. Propozimi i GP të PDK-së dhe GP të LDK-së për caktimin e deputetit Blerim Shala në delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë.*

* * *

Kryesia, dy pika të rendit të ditës të propozuara për seancë plenare: Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014 dhe Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014 i shtyu për seancën plenare të radhës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

- 1. Procedimi i Projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me projektligjin e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit, të hartuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, si dhe të përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji, në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

Pikat shitesë

- 1. Raport i kryetarit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Daut Haradinaj, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Turqi*

Kryesia u njoftua për vizitën zyrtare të realizuar nga kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Daut Haradinaj, në Turqi, prej 8-10 shkurt 2015.

2. Propozimi i GP të PDK-së dhe GP të LDK-së për caktimin e deputetit Blerim Shala, në delegacionin e Qeverisë për bisedime me Serbinë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, këtë çështje e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës, që do të mbahet më 16 prill 2015.

3. Kërkesa e Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa në shumën prej gjashtëmijë e pesëqind (6 500) euro për ndërtimin dhe vendosjen e një simboli dedikuar çështjes së personave të zhdukur.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere.
3. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që mjetet e lejuara në pikën një (1) të këtij vendit t'i derdhë në llogarinë rrjedhëse: KKAFZHK, nr. 100252855, Raiffesen BANK.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*